

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 711 Prot.

Tiranë, më 04.072016

**VENDIM Nr. 69, datë 28.06.2016**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 8 të datës 28.06.2016, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të *projektit "HEC Mollaj" mbi lumin e Dunavecit, Qarku Korçë-subjekti "ENERGJI XHACI" sh.p.k.*, realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Vangjel Dimo,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të *projektit "HEC Mollaj" mbi lumin e Dunavecit, Qarku Korçë-subjekti "ENERGJI XHACI" sh.p.k.*, realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Vangjel Dimo.
2. Shoqëria "ENERGJI XHACI" sh.p.k. duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me shoqëri të licencuar në arkeologji, e cila duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të ndërtimit të objektit "*HEC Mollaj" mbi lumin e Dunavecit, Qarku Korçë*, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë shoqëri.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të kontratës tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR**

**MIRELA KUMBARO FURXHI**

**MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA**

**RUDINA ZOTO**